


Tulipani shqiptar

Familja zambakore (*Liliaceae*) në vendin tonë, përfaqësohet nga shumë lloje, ku më i veçanti është Tulipani Shqiptar (*Tulipa albanica*). Ky lloj shfaqet në dy ngjyra, i kuq dhe i verdhë, me gjethe përgjithësisht të rrudhosura nga përmbajtja e lartë e metaleve të rënda në tokat serpentimore ku ai rritet. Periudha e lulëzimit është në muajt Prill-Maj.

Tulipani shqiptar është përshkruar në mënyrë shkencore dhe emërtuar për herë të parë në vitin 2008, duke e bërë një zbulim mjaft të vonë.



Ky lloj i ri për shkencën u rendit në vendin e 114-të në listën botërore të tulipanëve. Deri në zbulimin e këtij lloji, në Shqipëri mendohej se ekzistonte vetëm një lloj tulipani autokton, *T. australis*.

Ashtu si tulipanët e tjere, tulipani shqiptar është bimë barishtore shumëvjeçare me bulbe nëntokësore, të cilët rezervojnë lëndën ushqyese të bimës. Madhësia e bulbit varion nga 1.5-2.5 cm, ndërsa kërcelli arrin deri në 40 cm. Gjethet janë kryesisht ngjyrë e gjelbër në blu, të lidhura në bazën e kërcellit. Tulipani mban vetëm një lule (rrallëherë është vërejtur me 2).

Habitati i preferuar i këtij lloji janë mjediset e hapura dhe të thata me pyje dushku, në lartësitë 500-1100 m mbi nivelin e detit.

A e dinit se Tulipani Shqiptar tashmë është pjesë e logos së Prefekturës së Qarkut Kukës?



Statusi i Tulipanit shqiptar në Shqipëri

Ky lloj endemik i Shqipërisë gjendet vetëm në veri-lindje të vendit. Ai bën pjesë në listën e llojeve të rrezikuara të IUCN (Unionit Ndërkombëtar të Ruajtjes së Natyrës) ku mbart statusin “I rrezikuar në mënyrë kritike”, me një trend popullore në rënie.

Cilësia dhe shtrirja e habitatit të tulipanit shqiptar janë në rënie si rezultat i aktivitetit mineral, kullotjes dhe suksesionit biologjik.

Tulipani shqiptar është i pari lloj i vendit tonë, habitatit i të cilit mban statusin e monumentit të natyrës (Kategoria III e Zonave të Mbrojtura).


Bimët endemike

Bimët endemike janë lloje që gjenden vetëm në një territor të caktuar gjeografik, informacion i cili reflektohet edhe tek emri i bimës. Mjaft bimë, pas emrit të gjinisë shoqërohen me “albanicum, albanica”, që në gjuhën latine referohet si “shqiptar/e”.

Bimët endemike janë formuar si pasojë e copëzimit të relievit apo ndryshimeve drastike që kanë ndodhur me gjeologjinë dhe klimën.

Shqipëria është një nga vendet e Evropës që dallohet për endemizma. Në Shqipëri, bimët endemike ndodhen kryesisht në disa male dhe vargmale, sidomos në Shqipërinë Veriore dhe Verilindore. Por, një pjesë e mirë e tyre gjendet edhe në vende të ulëta. Bimët endemike kanë rëndësi shumë të madhe, duke filluar nga qëllimet shkencore, mjekësore, e deri te kultivimi i tyre si bimë zbukuruese.

- bimë vaskulare
- Tulipa albanica
- ★ Wulfenia baldacii
- ◆ Lilium albanicum
- ▲ Viola albanica



Shpërndarja e disa bimëve endemike në Shqipëri

Për shkak të përhapjes së tyre të kufizuar, bimët endemike preken lehtësisht ndaj ndryshimeve në mjedisin rrethues. Shumica e tyre kanë status kërcënimi dhe gjenden të përfshira në Listat e Kuqe kombëtare dhe ndërkombëtare.



Statusi
i Lilium
Albanicum
në
Shqipëri



Statusi
i Viola
albanica
në
Shqipëri

Bimët endemike janë pjesë e trashëgimisë natyrore të vendit tonë. Për këtë arsye, të gjithë ne duhet të përpiqemi t'i mbrojmë ato.


Skano këto për tu bërë pjesë e përpjekjeve për ruajtjen e bimëve endemike të Shqipërisë.



In partnership with



Supported by



Ajencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



Funded by
the European Union



Embassy
of the Federal Republic of Germany
Tirana



**TULIPANI
SHQIPTAR**
dhe bimët endemike



Albania is Biodiversity